

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7937
E premte, 22 nëntor 2024
Çmimi 0.50 €

A po luan qeveria e Mickovskit me themelet e shtetit të Maqedonisë së Veriut?

FAQE 3



Shkruan: Prof. dr. Ibrahim GASHI

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FJALIMI I VONSHËM I OSMANIT: RREZIKIMI I PARTNERITETIT ME ALEATËT E CENON MBROJTJEN E KOSOVËS

FAQE 4-5



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në fjalimin vjetor para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, ka bërë thirrje për ruajtjen e marrëdhënieve me vendet aleate, duke shtuar se

cenimi i raporteve me këto vende e cenon Kosovën. "Të punosh me ata që na kanë ndihmuar ta kemi lirinë e shtetit, asnjëherë nuk është nënshtrim e as shantazhim. Besoj fuqishëm

se forca jonë më e madhe qëndron pikërisht në aleancat tona", tha Osmani në Kuvendin e Kosovës. Fjalimin e Osmanit e ka bojkotuar grupi parlamentar i PDK-së dhe ai i AAK-së

BE-ja I KËRKON SERBISË TA SQAROJË PASIVIZIMIN E ADRESAVE TË SHQIPTARËVE NË LUGINË

F. 7



GJYKATA NDËRKOMBËTARE PENALE LËSHON FLETARRESTIME PËR NETANYAHUN DHE ZYRTARËT E HAMASIT

F. 8



AKTUALE



ISA MUSTAFA: EDHE VJOSA OSMANI ISHTE PJESE E DISKURISIT PËRÇARËS ME ALEATËT

F. 5

"SAVE THE CHILDREN": 'TIKTOK'-U, HAPËSIRA KU BULLIZOHEN MË SË SHUMTI FËMIJËT NË KOSOVË

F. 6

GËRVALLA TAKOHET ME HOVENIERIN, RITHEKSOHET PËRKUSHTIMI I KOSOVËS NË AGJENDËN EUROATLANTIKE

F. 3

EKONOMI



HASHANI: 1.3 MILIARD EURO TË PLANIFIKUARA PËR INVESTIME KAPITALE NUK U SHPENZUAN

F. 8

OPOZITA KUNDËRSHTON PROJEKTBUXHETIN E 2025-S, E CILËSON PLANIFIKIM KRIMINAL

F. 8

SPORT



GAZETARI RUMUN: NUK MUND TË KËNDOSH 'SERBI, SERBI' PARA NJË POPULLI TË MASAKRUAR NGA SERBIA

F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@ml.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Gjykata Ndërkombëtare Penale lëshon fletarrestime për Netanyahu dhe zyrtarët e Hamasit

HAGË, 21 NËNTOR - Gjykata Ndërkombëtare Penale (GJNP) ka lëshuar të enjten fletarrestime për kryeministrin e Izraelit, Benjamin Netanyahu, ish-ministrin e tij të Mbrojtjes, si dhe për zyrtarët e Hamasit, duke i akuzuar për krime lufte dhe për krime kundër njerëzimit për luftën në Rripin e Gazës dhe për sulmet e tetorit 2023 në Izrael.

Ky vendim nënkupton se Netanyahu dhe të tjerët tani kërkohen ndërkombëtarisht si të dyshuar dhe ka të ngjarë t'i izolojë ata edhe më shumë.

Njëkohësisht, ky vendim ka mundësi t'i ndërlikojë përpjekjet për arritjen e një armëpushimi për t'i dhënë fund luftës mbi njëvjeçare në mes të Izraelit dhe Hamasit - grupit palestinez i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. Megjithatë, këto fletarrestime mund të jenë të kufizuara në praktikë, duke qenë se Izraeli dhe aleat i tij kryesor, Shtetet e Bashkuara, nuk janë anëtarë të kësaj gjykate, ndërsa disa zyrtarë të Hamasit janë vrarë tashmë në këtë luftë.

Netanyahu dhe liderët e tjerë izraelitë e kanë dënuar kërkesën e kryeprokurorit të GJNP-së, Karim Khan, për lëshimin e fletarrestimeve për ta, duke e cilësuar si antisemitike.

Edhe presidenti amerikan Joe Biden e kishte kritikuar kërkesën e Khanit dhe kishte shprehur përkrahje për të drejtën e Izraelit për ta mbrojtur veten kundër Hamasit. Edhe Hamasi e kishte kritikuar kërkesën e kryeprokurorit. "Gjykata konsideron se ka arsye të bazuara për të besuar se të dy individët, qëllimshëm dhe me

dijeni, ia mohuan popullsisë civile në Gazë qasjen në objektet e domosdoshme për mbijetesën e tyre, duke përfshirë ushqimin, ujin, ilaçet dhe furnizimet mjekësore, si dhe karburantin dhe energjinë elektrike", shkroi paneli prej tre gjyqtarësh në vendimin e tyre për të lëshuar fletarrestime për Netanyahu dhe ish-ministrin izraelit të Mbrojtjes, Yoav Gallant.

Gjykata lëshoi fletarrestim edhe për Mohammed Deif, njërin nga liderët e Hamasit. Kryeprokurori i GJNP-së kishte kërkuar fletarrestime edhe për dy figurat e larta të Hamasit, Yahya Sinwar dhe Ismail Haniyeh, por që të dy janë vrarë në luftën në Gazë.

Ç'është Gjykata Ndërkombëtare Penale?

GJNP-ja është themeluar më 2002, si gjykatë e përhershme e nivelit më të lartë për ndjekjen penale të individëve përgjegjës për krimet më të rënda në botë - krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit, gjenocidin dhe krimin e agresionit.

Statuti i Romës, i cili ka paraparë krijimin e GJNP-së, është miratuar më 1998, dhe ka hyrë në fuqi kur ka arritur 60 ratifikime, më 1 korrik të vitit 2002. Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) e ka mbështetur GJNP-në, por gjykata është e pavarur.

Shtetet anëtare të GJNP-së, gjithsej 124, e kanë nënshkruar Statutin e Romës. Dhjetëra vende nuk e kanë nënshkruar dhe nuk e pranojnë juridiksionin e gjykatës për krime lufte, gjenocid dhe krime të tjera. Ndër to janë Izraeli, Shtetet e



Bashkuara të Amerikës, Rusia dhe Kina.

Pa një forcë policore, GJNP-ja varet nga shtetet anëtare për arrestimin e të dyshuarve, gjë që është dëshmuar të jetë pengesë e madhe për ndjekje penale.

GJNP-ja përfshihet kur vendet nuk mundin apo nuk shprehin vullnet t'i ndjekin penalisht krimet e kryera në territorin e tyre.

Ministria e Jashtme e Izraelit tha në shtator se kishte paraqitur dy dokumente ligjore që sfidojnë juridiksionin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale (GJNP) dhe argumentojnë se gjykata nuk i kishte dhënë Izraelit mundësinë për t'i hetuar vetë akuzat, para se të kërkonte fletarrestime.

"Asnjë demokraci tjetër me një sistem ligjor të pavarur dhe të respektuar, si ai i Izraelit, nuk është trajtuar në këtë mënyrë paragjyqese nga prokurori", shkroi zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme të Izraelit, Oren Marmorstein, në X.

Ai tha se Izraeli mbetet "i

palëkundur në angazhimin e tij për sundimin e ligjit dhe drejtësinë" dhe do të vazhdojë t'i mbrojë qytetarët e tij kundër militantizmit.

GJNP-ja është gjykatë e instancës së fundit që ndjek penalisht rastet vetëm kur autoritetet vendore të zbatimit të ligjit nuk mundin, ose nuk duan t'i hetojnë. Izraeli nuk është shtet anëtar i GJNP-së. Vendi ka pasur vështirësi ta hetojë vetveten në të kaluarën, thonë grupet për të drejtat e njeriut.

Pavarësisht prej fletarrestimeve, asnjë nga të dyshuarit nuk pritet të dalin para gjyqtarëve në Hagë së shpejti. Vetë gjykata nuk ka politikë për t'i zbatuar fletarrestimet, por mbështetet në bashkëpunimin e shteteve anëtare.

Megjithatë, rreziku për t'u arrestuar mund ta bëjë të vështirë për Netanyahu dhe Gallantin të udhëtojnë jashtë vendit, edhe pse presidenti rus Vladimir Putin, i cili kërkohet nga GJNP-ja për krime të dyshuara lufte në Ukrainë,

tregoi kur e vizitoi Mongolinë, vend anëtar i gjykatës, rishtazi se ai mund të udhëtojë jashtë vendit dhe të mos arrestohet prapëseprapë.

Khan bëri kërkesë për fletarrestime në maj, duke i akuzuar Netanyahu dhe Gallantin për krime, duke përfshirë vrasje, sulme të qëllimshme ndaj civilëve dhe përndjekje.

Në lidhje me liderët izraelitë, Khan në mënyrë specifike i nënvizoi si arsye për fletarrestime "shkaktimin e urisë te civilët si mjet lufte", "shkaktimin e vuajtjeve të mëdha me qëllim", "udhëheqjen e qëllimshme të sulmeve ndaj popullsisë civile" dhe "veprimet e tjera çnjerëzore".

Khan i akuzoi tre liderët e Hamasit se janë përgjegjës për "shfarosje", "rrëmbim", "përdhunim dhe vepra të tjera të dhunës seksual", "torturë" dhe "vepra çnjerëzore", gjatë sulmit të Hamasit në jug të Izraelit më 7 tetor 2023, ku u vranë 1 200 njerëz dhe u rrëmbyen 250 të tjerë.

Sulmi i Hamasit e nxiti luftën e Izraelit në Gazë.

Prej atëherë, hakmarrja e Izraelit e ka shkatërruar Gazën, si dhe i ka vrarë mbi 44 000 njerëz, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në Gazë, e cila udhëhiqet nga Hamasi.

Grupet për të drejtat e njeriut e kanë përhëndetur vendimin, i cili u mor mbi gjashtë muaj pasi Khan i bëri kërkesën. "Fletarrestimet e GJNP-së për liderët e lartë izraelitë dhe një zyrtar të Hamasit thyejnë perceptimin se disa individë janë të pakapshëm për ligjin", tha në një deklaratë Balkees Jarrah, drejtoreshë për drejtësi ndërkombëtare në Human Rights Watch.

Vullkani në Islandë shpërthen për herë të shtatë brenda një viti

REKJANES, 21 NËNTOR - Një vullkan në gadishullin e Rekjanes në jugperëndim të Islandës ka shpërthyer për herë të shtatë prej dhjetorit të kaluar, duke lëshuar lavë nga një çarje e madhe.

Shpërthimi nisi me pak paralajmërime të mërkurën pak para mesnatës dhe e krijoi një çarje rreth 3 kilometra të gjatë. Megjithatë, kjo çarje vlerësohet më e vogël sesa ajo nga shpërthimi i fundit në gusht, tha Zyra Meteorologjike e Islandës. "Ky është paksa më i vogël sesa

shpërthimi i kaluar dhe shpërthimi që ndodhi në maj", tha Magnus Tumi Gudmundsson, profesor i gjeofizikës, i cili e vëzhgoi nga ajri shpërthimin e këtij vullkani.

Derisa ky shpërthim nuk përbën rrezik për transportin ajror, autoritetet kanë paralajmëruar për emetime të gazit përgjatë pjesëve të gadishullit, përfshirë në afërsi të qytezës Grindavik. Shpërthimet e vazhdueshme vullkanike në afërsi të Grindavikut, e cila ka 3 800



banorë dhe ndodhet rreth 50 kilometra larg kryeqytetit Reikjavik, kanë shkaktuar dëme ndaj infrastrukturës dhe pronës dhe i kanë detyruar shumë prej banorëve të zhvendosen për sigurinë e tyre. "Grindaviku nuk është në rrezik, sepse nuk duket se kjo çarje do të zgjerohet, edhe pse gjithçka mund të ndodhë", tha Magnus Tumi. Banorët e rreth 50 shtëpive u evakuuan menjëherë, pasi agjencia për mbrojtje civile lëshoi alarmin, raportoi transmetuesi shtetëror RUV.

A po luan qeveria e Mickovskit me themelet e shtetit të Maqedonisë së Veriut



Shkruan: Prof. dr. Ibrahim GASHI

Dy fjalë për Marrëveshjen e Ohrit (2001)

Marrëveshja Kornizë e Ohrit (MKO) e vitit 2001 konsiderohet gjerësisht si një gur themeli i shtetit modern të Maqedonisë së Veriut. E nënshkruar më 13 gusht 2001, ajo shënoi fundin e një konflikti të armatosur gjashtëmuor midis qeverisë së Maqedonisë së Veriut dhe Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare Shqiptare (UÇK). Marrëveshja u ndërmjetësua me ndihmën e komunitetit ndërkombëtar, duke përfshirë Bashkimin Evropian, NATO-n dhe Shtetet e Bashkuara, dhe hodhi themelet për një kornizë politike më gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Rëndësia historike dhe praktike e kësaj marrëveshje konsiston mbi të gjitha në faktin se ajo i dha fund me sukses konfliktit të armatosur, duke shmangur rrezikun e një lufte civile në shkallë të gjerë. Duke adresuar kërkesat e grupit të dytë më të madh etnik në vend (shqiptarëve) përmes dialogut dhe negociatave, marrëveshja nënvizoi rëndësinë e zgjidhjes paqësore të konfliktit. Më tej Marrëveshja pranoi natyrën

multietnike të Maqedonisë së Veriut dhe synonte të sigurote të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga përkatësia etnike. Më saktësisht ajo parashikonte: Të drejtat gjuhësore: Përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe në komunat ku shqiptarët përbëjnë së paku 20% të popullsisë. Të drejtat kulturore: Mbështetje për ruajtjen dhe promovimin e identiteteve kulturore të pakicave etnike.

Përtej funksionit primar marrëveshja pati si aspekt të rëndësishëm, atë të decentralizimit të pushtetit, duke dhënë një autonomi më të madhe komunave. Kjo kishte për qëllim të fuqizonte qeveritë lokale dhe të sigurote që pakicat etnike të kishin një zë më të fortë në proceset vendimmarrëse. Përfaqësimi proporcional në administratën publike dhe institucionet tjera shtetërore ishte një tjetër komponent kyç, duke siguruar që bashkësitë etnike të ishin të përfaqësuara në mënyrë të drejtë. Marrëveshja si e tillë u hapi rrugë ndryshimeve kushtetuese për të pasqyruar të drejtat e pakicave dhe karakterin multikulturor të shtetit. Këto ndryshime që atëherë kanë formuar kuadrin ligjor dhe

institucional për një shoqëri më gjithëpërfshirëse, duke nënvizuar në veçanti sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe nevojën për mosdiskriminim.

Një segment tepër i veçantë sa i takon rëndësisë historike dhe politike të MKO është fakti se kjo marrëveshje duke adresuar tensionet etnike dhe duke promovuar qeverisjen demokratike, luajti një rol kryesor në stabilitetin e vendit. Ky stabilitet ishte thelbësor për aspiratat e Maqedonisë së Veriut për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian dhe NATO, pasi respektimi i parimeve demokratike dhe të drejtave të njeriut është një parakusht për anëtarësim.

Si përfundim Marrëveshja Kornizë e Ohrit mbetet një element themelor i shtetësisë dhe evolucionit demokratik të Maqedonisë së Veriut. Duke institucionalizuar të drejtat etnike dhe decentralizimin, ajo ka ofruar një kornizë për bashkëjetesë dhe stabilitet në një shoqëri multietnike. Suksesi i saj nënvizon rëndësinë e dialogut dhe kompromisit në ndërtimin e një shteti të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

Pse nuk bënë të vihet dorë mbi këtë marrëveshje përmes tentim ndryshimit të Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve në RMV?

Nismat e pushtetit të ri në RMV që të amandamentohet Ligji mbi përdorimin e gjuhëve (LPGJ) në RMV është oguri më i keq dhe veprimi më i rrezikshëm i kabinetit aktual qeveritar në Shkup. Një nismë e tillë qoftë edhe si tentativë bartë me vetë konsekuenca serioze politike, sociale, kulturore, ligjore-institucionale, ekonomike dhe ndërkombëtare. Të gjithë ata që mendojnë ndryshe dhe e relativizojnë në çfarëdo forme rrezikun e prekses së këtij ligji sigurisht se me apo pa vetëdije i kontribuojnë prishjes së një kohezioni të rëndësishëm në raportet midis dy komuniteteve më të mëdha etnike (maqedon dhe shqiptar) në Maqedoninë e Veriut, të arritur me MKO (2001) dhe të implementuar me këtë ligj, të miratuar në vitin 2018, duke e bërë gjuhën shqipe si gjuhën e dytë zyrtare në Maqedoni të Veriut (shih: Neni 3 i LPGJ të RMV).

Nëse këto tentim ndryshime do të kalonin në Gjykatën Kushtetuese të RMV pasojat do të ishin, sikundër e thamë më lartë, të tilla që drejtpërdrejt apo kontekstualisht të kontribuojnë në destabilizimin e ekuilibrit të brishtë ndëretnik dhe të çojë në trazira të ripërtëritura politike ose sociale.

Gjithnjë në sensin hipotetik, por edhe lehtësisht të mundshëm që të ndodh, nëse Ligji në fjalë prekët në substancën e tij kjo do të mund të prodhonte një situatën kur partitë politike shqiptare etnike do ta kundërshtonin fuqimisht masën, duke çuar në ngërç politik, bojkot, apo edhe rënie të qeverive të koalicionit. Partitë nacionaliste maqedonase etnike, nga ana tjetër, mund të shfrytëzojnë situatën, duke nxitur polarizimin. Një efekt domino do të ishte pothuaj i pashmangshëm që një vendim i tillë të provokojë protesta dhe demonstrata, veçanërisht në rajonet me një popullsi të konsiderueshme shqiptare. Në rastin më të keq, mund

të përshkallëzohet në përplasje të dhunshme, që të kujtojnë konfliktin e vitit 2001.

Pasojat e një skenari të tillë do të ishin edhe në planin social duke ndikuar drejtpërdrejt në marginalizimin e shqiptarëve dhe sulm ndaj identitetit dhe të drejtave të tyre, duke thelluar ndjenjat e përjashtimit dhe të pabarazisë, duke rritur kështu mosbesimin dhe tensionet ndërmjet maqedonasve etnikë dhe shqiptarëve, që drejtpërdrejt do të ndikonte aksesueshmëri të reduktuar të shqiptarëve në Shërbimet Publike, veçmas në zonat rurale.

Pa e ekzagjeruar në asnjë moment situatën që mund të prodhonte prekja e këtij ligji, konsiderojmë se pasojat do të jenë shumë më të mëdha se sa mund të parashikohen. Si konsekuenca potenciale në një situatë të mundshme të prekses së këtij ligji do të mund të listonim edhe efektet e drejtpërdrejta negative në jetën ekonomike të shqiptarëve përmes ndikimit në rënien e ritmeve të zhvillimit rajonal duke përkeqësuar më tej sfidat demografike përmes rritjes së migrimit.

Në fund, por jo nga rëndësia ndërhyrja në përmbajtjet esenciale të Ligjit do të prodhonte pashmangshmërisht edhe konsekuenca ndërkombëtare për shtetin dhe popullin e RMV të tilla si dëmtimi i perspektivës së anëtarësimit në BE, duke rrezikuar negociatat e pranimit të Maqedonisë së Veriut dhe duke nxitur organizatat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe aktorët rajonalë, veçanërisht Shqipërinë dhe Kosovën, që potencialisht do të ndikonte në marrëdhëniet diplomatike të tyre me RMV. Në sytë e partnerëve ndërkombëtar të Maqedonisë imazhi i Maqedonisë së Veriut si një shtet multietnik, do të lëkundej seriozisht, duke nxitur një perceptim se vendi i jep përparësi një grupi etnik mbi të tjerët.

Si përfundim humbja e përfaqësimit gjuhësor do të bënte qytetarët shqiptarë të RMV të ndjeshëm se gjuha dhe kultura e tyre po shtypen në mënyrë aktive, duke çuar kështu në humbjen e besimit në institucionet shtetërore dhe në perspektivën e ruajtjes së shtetit unitar të RMV.

Gërvalla takohet me Hovenierin, ritheksohet përkushtimi i Kosovës në agjendën euroatlantike

Prishtinë, 21 nëntor - Ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, ka pritur në takim ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey Hovenier.

MPJD ka njoftuar se takimi i rregullt mes tyre pati në fokus

partneritetin e ngushtë mes dy shteteve, realizimin e projekteve të përbashkëta në demokratizim dhe zhvillim të qëndrueshëm. Ministrja Gërvalla ka ritheksoar përkushtimin e vendit për avancimin e agjendës euroatlantike dhe forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar.

"Ajo shprehu mirënjohje të thellë për mbështetjen e vazhdueshme dhe të gjithanshme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës si një partner i fuqishëm dhe kontribuues kryesor në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në rajon dhe Evropë", ka njoftuar MPJD.





Fjalimi i vonshëm i Osmanit: Rrezikimi i partneritetit me aleatët e cenon mbrojtjen e Kosovës

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në fjalimin vjetor para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, ka bërë thirrje për ruajtjen e marrëdhënieve me vendet aleate, duke shtuar se cenimi i raporteve me këto vende e cenon Kosovën. “Të punosh me ata që na kanë ndihmuar ta kemi lirinë e shtetit, asnjëherë nuk është nënshtrim e as shantazhim. Besoj fuqishëm se forca jonë më e madhe qëndron pikërisht në aleancat tona”, tha Osmani në Kuvendin e Kosovës. Fjalimin e Osmanit e ka bojkotuar grupi parlamentar i PDK-së dhe ai i AAK-së

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në fjalimin vjetor para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, ka bërë thirrje për ruajtjen e marrëdhënieve me vendet aleate, duke thënë se cenimi i raporteve me këto vende e cenon Kosovën. Ajo e cilësoi të pabalancuar dialogun me Serbinë dhe kërkoi trysni ndërkombëtare ndaj Serbisë për respektimin e të drejtave të shqiptarëve atje.

Duke folur të enjten në një seancë parlamentare të bojkotuar nga dy prej tri subjekteve më të mëdha

opozitare, Partia Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, presidentja e vendit tha se “aleanca e Kosovës me vendet e tjera është më e madhe dhe më e rëndësishme se cilido prej nesh si politikan”. “Të punosh me ata që na kanë ndihmuar ta kemi lirinë e shtetit, asnjëherë nuk është nënshtrim e as shantazhim. Besoj fuqishëm se forca jonë më e madhe qëndron pikërisht në aleancat tona”, tha Osmani në Kuvendin e Kosovës.

Ajo bëri thirrje që Kosova t’i ruajë aleancat e saj, sepse ato, sipas saj, janë “gur themeltar i sukseseve tona dhe investim në të ardhmen tonë, ku

Kosova do të jetë anëtare e barabartë në komitetin euroatlantik të kombeve të lira”. “Aleancat janë këtu për të na mbrojtur, prandaj vënia në rrezik e tyre, luajtja bixhoz me to, apo cenimi i tyre, e cenon vetë mbrojtjen e republikës sonë”, tha ajo. Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti nga Lëvizja Vetëvendosje, është kritikuar dhe akuzuar gjatë këtij viti nga Shtetet e Bashkuara, aleatja kryesore e vendit, si dhe nga Bashkimi Evropian, për veprime të “njëanshme dhe të pakoordinuara” në veriun e banuar me shumicë serbe.

Gjatë këtij viti Qeveria e

Kosovës ka ndërmarrë një sërë hapash për ta shtrirë autoritetin në veriun e banuar me shumicë serbe, duke mbyllur institucionet paralele serbe.

Kurti vazhdimisht këmbëngul se veprimet e qeverisë së tij nuk janë të drejtuara kundër askujt, se ndjek Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës dhe se marrëdhëniet me ShBA-në janë të mira, me gjithë mospajtimet për disa çështje. Presidentja Osmani tha gjatë adresimit të saj se “asnjëherë nuk i kam kuptuar e as mirëkuptuar as talljet që bëhen në llogari të aleatëve, as sulmet ndaj tyre, as keqpërdorimin e tyre për të fituar pushtet. As njëra e as tjetra nuk i bën nder Kosovës”.

Ajo i bëri thirrje spektrit politik të ketë angazhim të madh vitin e ardhshëm për anëtarësimin e vendit në organizata ndërkombëtare. “Ka disa gjëra që kërkojnë vëmendje dhe angazhimin e të gjithëve gjatë vitit 2025. Anëtarësimi në Këshillin e Evropës, avancimi i aplikimit

të Kosovës për anëtarësim në BE, si dhe fillimi i procesit të anëtarësimit në NATO, duhet të jenë suksese të vitit 2025”, tha ajo.

Kosova kishte aplikuar për anëtarësim në BE në dhjetor të vitit 2022, por ende nuk e ka statusin e vendit kandidat. Ndërkaq, aplikimi për anëtarësim në Këshillin e Evropës nuk pati sukses për shkak se u kushtëzua me Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë.

Presidentja Osmani tha se dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian që prej vitit 2011, ka qenë “fatkeqësisht i pabalancuar” dhe bëri thirrje për reflektim. Ajo theksoi se Kosova “është trajtuar padrejtësisht”, ndërsa Serbia është “akomoduar vazhdimisht”. “Fakti që në tavolinën e dialogut sot, shteti që kreu agresion ndaj Kosovës nuk është nën masa, kurse viktima e këtij agresioni, Kosova, është nën masa, është dëshmia më e qartë e kësaj. Prandaj, është e domosdoshme të ketë

reflektim rreth kësaj qasjeje nga të gjithë ata që vërtet duan paqe dhe stabilitet afatgjatë në rajonin tonë”, deklaroi presidentja Vjosa Osmani. “Por, kjo nuk do të thotë se edhe ne nuk duhet të vetëreflektojmë për rrugën e deritashme dhe si mund t’i bëjmë gjërat më mirë”, u shpreh ajo.

Osmani tha se këshillat e saj për përmirësimin e procesit të dialogut kanë qenë në shënjestër të “sulmeve të ulëta dhe dezinformatave që s’i kanë hije askujt në Kosovë”. “Për të qenë edhe më e qartë, kur unë kam propozuar që drafti i Asociacionit të fillohet të diskutohet me ShBA-në, në mënyrë që kjo çështje mos t’i lihet as Lajçakut e as të tjerëve që nuk besojnë në pavarësinë e Kosovës, kjo nuk ka nënkuptuar që unë po kërkoj themelimin të Asociacionit, por ka nënkuptuar se më shumë i kam besuar vetvetes sonë dhe

Amerikës, sesa disa burokratëve nga shtetet jonjohëse”, theksoi ajo.

Themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë është ndër pikat kryesore të marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Osmani tha se është akuzuar padrejtësisht dhe me “lloj-lloj shpifjesh të ulëta” se ajo ka kërkuar nënshkrimin e njëanshëm të marrëveshjes.

Osmani tha se kishte theksuar se zbatimi i marrëveshjes ka kuptim vetëm nëse zbatohet nga të dyja palët dhe se, si alternativë, ajo kishte kërkuar që Kosova, nëse e sheh që Serbia nuk po e zbaton pjesën e saj, të diskutojë me aleatët për zbatimin e përgjegjësive që ka në marrëveshje, nëse merr garanci për sigurinë nga ShBA-ja, përfshirë anëtarësim në NATO. “Thënë troc, për mua, më shumë sesa nënshkrimi i presidentit të Serbisë, ka rëndësi

nënshkrimi i presidentit të Amerikës. Shpresoj që jam mjaftueshëm e qartë”, tha Osmani.

Presidentja e Kosovës kërkoi nga bashkësia ndërkombëtare t’i bëjë trysni Serbisë për respektimin e të drejtave të shqiptarëve në jug të vendit.

Shqiptarët nga Lugina e Preshevës që një kohë të gjatë ankohen për pasivizimin e adresave të banimit të tyre në Serbi. Pasivizimi nënkupton fshirjen e qytetarëve prej adresave ku kanë qenë të regjistruar. “Sot ka akoma shqiptarë në rajon që përballen me vështirësi dhe shkelje të të drejtave të njeriut. Në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc, spastrimi etnik nëpërmjet pasivizimit të adresave, që është konfirmuar edhe nga Parlamenti Evropian, Departamenti Amerikan i Shtetit, tashmë ka marrë edhe vullën e gjykatave të politizuara të Serbisë, të cilat po e mirëmbajnë diskriminim”, tha Osmani.

PDK-ja: Osmani edhe në vitin e katërt të mandatit të saj ka vazhduar të sillet në shpërputhje të plotë me rolin e saj kushtetues

Grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka refuzuar edhe këtë vit pjesëmarrjen në seancën e thirrur për adresimin vjetor të presidentes Vjosa Osmani ngaqë, sipas tij, e njëjta ka vazhduar të sillet me mospërbushje shqetësuese të rolit dhe funksionit të saj kushtetues. “Znj. Osmani si presidente duke qenë njëkohësisht edhe udhëheqëse e politikës së jashtme ka dështuar përfundimisht në realizimin e ndonjë suksesi të vetëm në përfaqësimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar të Kosovës. Si presidente, nuk ka arritur që Kosovës t’i sigurojë qoftë edhe një njohje të vetme, siç ka dështuar në fushën e anëtarësimin të vendit në ndonjë organizatë ndërkombëtare. Për më tepër, si presidente ka vazhduar të qëndrojë e heshtur ndaj masave dhe sanksioneve që BE-ja i ka vënë Kosovës si rezultat i çasjes destruktive të qeverisë dhe në asnjë rast të vetëm nuk është sjell dhe nuk ka vepruar si kundër-balancuese e politikave të gabuara të qeverisë të cilat vendin e kanë ekspozuar përballë izolimit ndërkombëtar”, është thënë në njoftimin e PDK-së.

Sipas PDK-së, Osmani edhe në vitin e katërt të mandatit ka vazhduar të sillet në shpërputhje të plotë me rolin e saj kushtetues për ta përfaqësuar unitetin e popullit duke demonstruar njëanshmëri ndaj Albin Kurtit. “Ndërkaq, edhe si Komandante Supreme e Forcës së Sigurisë së Kosovës ka heshtur përballë skandalit

të pashembullt të dështimit të sigurimit të ushqimit për ushtrinë tonë. Nga ana tjetër, ka vazhduar të hesht edhe përballë aferave të vazhdueshme korruptive të qeverisë, siç nuk e ka marrë asnjë edhe një masë për shkarkimin e protagonistit të aferës së energjisë, ambasadorit Martin Berishaj, vendimi për emërimin e të cilit e mban vullën e saj. Për më keq, ka vazhduar ta mbrojë ambasadorin Berishaj dhe çdo skandal tjetër që ka ndodhur gjatë këtij viti. Edhe këtë vit, jo vetëm që i ka mbyllur sytë përballë skandaleve dhe aferave korruptive të kësaj qeverie, por i është bashkuar fushatës qeveritare për të sulmuar institucionet e pavarura të drejtësisë dhe në rastin më të keq ka vazhduar shkeljen e saj kushtetuese për mosdekretimin e Kryeprokurorit të Shtetit”, ka theksuar PDK-ja, duke shtuar se, në vend se t’i mbështeste në mënyrë institucionale pavarësinë dhe integritetin e institucioneve të drejtësisë, ajo ka penguar punën e tyre, duke penguar kështu edhe luftën kundër korrupsionit dhe dukurive negative. “Tashmë kur janë mbushur gati katër vite të mandatit të saj si presidente, ajo ka dështuar për të lënë një gjurmë të vetme të suksesshme për Kosovën, ndërsa roli i saj tërësisht i pavërejtshëm është kthyer në një faktor të dëmshëm për shtetin e Kosovës dhe qytetarët e saj. Fatkeqësisht, kontributi i vetëm i saj në këto katër vite është zbehja e rolit dhe rëndësisë së institucionit të Presidentit si dhe promovimi i gjuhës polarizuese dhe përçarëse në skenën politike. Një presidente e tillë e cila e reduktion pozitën e institucionit të Presidentit si një mekanizëm për akomodimin e interesave familjare dhe partiake nuk e meriton respektin e Grupit Parlamentar të PDK-së”, është thënë në njoftimin e PDK-së.



Isa Mustafa: Edhe Vjosa Osmani ishte pjesë e diskursit përçarës me aleatët

Prishtinë, 21 nëntor - Ish-kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, i ka quajtur të vonuara vërejtjet e presidentes Vjosa Osmani ndaj qeverisë në fjalimin e saj vjetor.

Sipas tij, edhe presidentja Osmani e ka përkrahur diskursin përçarës të qeverisë me aleatët e Kosovës. “Unë mendoj se janë vërejtje shumë të vonshme të presidentes sepse ajo këto po i thotë në fund të mandatit të kësaj qeverie, nuk i ka thënë asnjëherë deri më tani në tre fjalimet e saj që ka pasur në Kuvend dhe në këtë shumicë parlamentare. Unë mendoj se edhe vetë presidentja është aktore ose pjesëmarrëse e të

gjitha këtyre ndodhive që kanë ndodhur nga ndërkombëtarët sepse edhe ajo deri më tani e ka përkrahur këtë kurs të qeverisë. E ka përkrahur tezën e sovranizmit që ne jemi shtet sovran dhe nuk mundet askush që të përzihet këtu. Bile ka pasur vërejtje edhe në raport me ShBA-në në një periudhë. Mirëpo, mirë që është vetëdijësuar në fund nuk do të thotë se tani i kthen të gjitha ato humbje dhe të gjithë atë dëm që e ka pësuar vendi ynë prej atij kursi të shumicës parlamentare, pjesë e së cilës ka qenë edhe presidentja”, ka thënë Mustafa. /RTV21



Kurti: Për herë të parë kemi shënuar bilanc pozitiv tregtar me Zvicrën

Prishtinë, 21 nëntor - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, mori pjesë në forumin ekonomik Zvicër - Kosovë 2024, ku ishte i ftuar për fjalë hyrëse të forumit. Duke qenë se Kosova dhe Zvicra kanë një partneritet të fortë, kulturor dhe politik, kryeministri Kurti në fillim të fjalës së tij tha se është e

natyrshme që kjo lidhje forcohet ekonomikisht çdo ditë, ndërkaq falënderoi të gjithë ata që punojnë në këtë drejtim. "Ne jemi të bekuar me këtë partneritet, ose më mirë, me këtë miqësi të vërtetë. Ndaj më vjen mirë që ky forum na ofron mundësinë për të thelluar këtë partneritet, veçanërisht

në fushën e tregtisë, investimeve dhe inovacionit teknologjik", veçoi kryeministri, teksa theksoi se për Kosovën Zvicra është destinacioni i pestë më i madh i eksporteve dhe në vitin 2022 për herë të parë kemi shënuar bilanc pozitiv tregtar me Zvicrën duke eksportuar mallra në vlerë

prej 64 milionë eurosh dhe importuar mallra në vlerë prej 39 milionë eurosh. Kryeministri Kurti tha se jemi të përkushtuar për të krijuar një mjedis biznesi që tërheq investime dhe nxit një rritje të qëndrueshme. "Së bashku, le ta hapim rrugën për një partneritet më të fortë dhe më të begatë



ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës", tha ai në përfundim të fjalës.

"Save the Children": 'TikTok'-u, hapësira ku bullizohen më së shumti fëmijët në Kosovë

Prishtinë, 21 nëntor - Fëmijët në Kosovë kanë thënë se bullizimi kryesisht ndodh në rrjetet sociale dhe në shkolla, sipas një ankete të realizuar nga organizata për të drejtat e fëmijëve, "Save the Children Kosova".

Sipas anketës, Zërat e Rinj, 78 për qind e fëmijëve thanë se bullizimi është shumë ose mesatarisht i pranishëm në shkollën e tyre. E njëjta përqindje vlen edhe për "TikTok"-un, pasuar nga rrjeti tjetër social "Snapchat" me 57 për qind.

Të anketuarit kanë thënë se bullizim ndodh edhe në "Instagram" (45 për qind) dhe "Facebook" (28 për qind) si hapësira ku bullizimi ndodh shpesh apo gjithmonë.

Anketa është realizuar në periudhën maj-qershor 2024 dhe në të kanë marrë pjesë 1 071 fëmijë në 16 komuna të Kosovës.


Fëmijët e anketuar ishin nga mosha 11 deri 17 vjeç, pra nxënës nga klasa e shtatë deri

në të 11-tën. Sipas anketës, 29 për qind e fëmijëve kanë raportuar se rrallë apo kurrë nuk ndihen të sigurt kur përdorin transportin publik gjatë natës. "Ky shqetësim është më i theksuar te vajzat, ku 35 për qind e shprehin këtë krahasuar me 19 për qind të djemve", tha Save the Children.

Kjo organizatë ka kërkuar që në shkolla të ketë mekanizma më të fortë për t'i trajtuar menjëherë bullizimin dhe diskriminimin, duke ofruar "trajnime gjithëpërfshirëse për mësimit dhe prindërit dhe nxënësit që këto çështje të trajtohen së bashku".

Po ashtu, është kërkuar të ketë siguri në internet dhe mekanizëm më të mirë mbrojtës për platformat sikurse "TikTok" dhe "Snapchat", duke i "angazhuar kompanitë e teknologjisë, prindërit dhe mësimit në këtë përpjekje".

"Save the Children", po ashtu, kërkoi që institucionet të



veprojnë me urgjencë për ta përmirësuar sigurinë në transportin publik, veçmas gjatë natës, përmes masave më të mira të sigurisë, ndriçimit dhe fushatave të ndërgjegjësimit.

Së fundi, në Kosovë janë raportuar disa raste të vetëlëndimeve të nxënësve të frymëzuar nga disa video në "TikTok". Njohësit e fushës i kanë thënë më herët "Radios Evropa e Lirë" se institucionet

duhet të gjejnë mekanizma efektivë për parandalimin e ndikimit të përmbajtjeve të dëmshme nga rrjetet sociale, duke rekomanduar ose kontrollin e shtuar apo ndalimin e qasjes në "TikTok".

Klinaku godet Kurtin: Asnjë kryeministër servil i Kosovës dhe parti politike në Maqedoni nuk mund t'i nënshtrojnë shqiptarët



Prishtinë, 21 nëntor - Ushtruesi i detyrës së kryetarit të Organizatës për Veteranët e Luftës së UÇK-së, Faton Klinaku, është përfshirë në debatin për gjuhën shqipe në Maqedoninë e Veriut. Duke iu referuar deklaratës së kryeministrit Albin Kurti në lidhje me Ligjin për Gjuhët në

Maqedoninë e Veriut, Klinaku ka thënë se asnjë kryeministër servil i Kosovës dhe as ndonjë parti politike shqiptare në Maqedoni të Veriut nuk mund t'i nënshtrojnë shqiptarët. "Asnjë kryeministër servil i Kosovës, e as ndonjë parti politike shqiptare në Maqedoninë e Veriut, nuk

mund t'i nënshtrojnë shqiptarët për të ruajtur e avancuar të drejtat e tyre si komb. Nuk është çështje vetëm përdorimi i gjuhës shqipe, por nëse shqiptarët nuk do të jenë popull shtetformues atje, Maqedonia nuk do të ekzistoj si shtet", ka shkruar Klinaku në "Facebook".

Zëvendëskryeministri Bislimi udhëton për Poloni

Prishtinë, 21 nëntor - Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi, ka udhëtuar drejt

kryeqendrës së Polonisë, Varshavës. Në këtë vizitë zyrtare, zëvendëskryeministri do të marrë pjesë në konferencën e organizuar nga "Trans

European Policy Studies Association" (TEPSA), ku do të jetë folës në panelin me titull "Who Should be the Real Time-Keeper in EU Enlargement?", si dhe do të

ketë takime bilaterale me zyrtarë qeveritarë dhe parlamentarë të Polonisë, edhe me ministrin për Bashkim Evropian të Polonisë, Adam Szapka.



BE-ja i kërkon Serbisë ta sqarojë pasivizimin e adresave të shqiptarëve në Luginë

Prishtinë, 21 nëntor - Bashkimi Evropian ka thënë se është në dijeni për shqetësimet e shqiptarëve në jug të Serbisë në lidhje me pasivizimin e adresave të tyre, dhe i ka bërë thirrje përsëri Beogradit të japë sqarime për këtë çështje, tha të enjten zëdhënësja për zgjerim në Komisionin Evropian, Ana Pisonero.

Gjatë kësaj jave Gjykata Kushtetuese e Serbisë ia hodhi poshtë ankesën një banori shqiptar nga Medvegja për kthimin e adresës së tij, duke nxitur reagime.

Pisonero nuk deshi t'i komentojë vendimet e gjyqësorit serb për rastet e pasivizimit të adresave të shqiptarëve, por e përsëriti shqetësimin që BE-ja e kishte shprehur edhe në Raportin e Progresit për Serbinë muajin e kaluar. "Ne kemi marrë dijeni për shqetësimet e pasivizimit të adresave të pjesëtarëve të komunitetit shqiptar në Serbi. Jemi duke ndjekur këto zhvillime në frymën e obligimeve që ka marrë Serbia në kuadër të negociatave të anëtarësimit, sidomos ato që kanë të bëjnë me të drejtat e pakicave", tha Pisonero.

Në Serbi jetojnë më shumë se 60 000 shqiptarë të cilët përbëjnë pakicën e katërt më të madhe atje, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë më 2022. Në raportet ndërkombëtare, Lugina e Preshevës - term që përdoret për Preshevën, Medvegjën dhe Bujanocin, komuna të banuara me shumicë shqiptare në jug të Serbisë - konsiderohet



tërësisht e izoluar dhe thuhet se merr vëmendje vetëm në kohë zgjedhjesh.

Shqiptarët e Luginës së Preshevës e kanë ngritur zërin kundër diskriminimit që ata thonë se e përjetojnë çdo ditë në Serbi, duke mbajtur disa protesta në muajt e fundit. Pisonero tha se BE-ja e ka bërë të qartë se ka nevojë që autoritetet e Serbisë të sqarojnë për publikun se si janë kryer kontrollet e vendbanimeve që kanë rezultuar me pasivizimin e adresave dhe nëse jugu i Serbisë është vënë në shënjestër veçanërisht.

Në Raportin e Progresit për

Serbinë, në pjesën ku flitet për sundimin e ligjit dhe të drejtat themelore, është përmendur edhe çështja e pasivizimit të adresave të Shqiptarëve në Luginën e Preshevës. "Pjesëtarë të komunitetit pakicë shqiptar kanë ngritur shqetësimet lidhur me mënyrën se si policia ka bërë kontrolle të statusit të banorëve në jug të Serbisë, që ka rezultuar me pasivizimin e disa adresave. Ekziston nevoja që autoritetet e Serbisë t'ia sqarojnë më mirë publikut se si janë kryer këto kontrolle. Zbatimi i planit të veprimit për përmirësimin e përfundimit të shqiptarëve në institucione

duhet të avancohet dhe të sjellë përmirësime të prekshme", sipas raportit. Në BE nuk janë përgjigjur në mënyrë të drejtpërdrejtë nëse kjo çështje mund të jetë pjesë e dialogut për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë, por kanë thënë disa herë se ajo është pjesë e detyrimeve të Serbisë në procesin e integritetit në BE, prandaj reflektohet edhe në raportet vjetore të progresit. Kosova ka ngritur disa herë në procesin e dialogut si çështje edhe pasivizimin e adresave të shqiptarëve në Luginën e Preshevës, duke kërkuar që edhe kjo të jetë pjesë në dialog.

Të mërkurën zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, e akuzoi Serbinë se po legjitimon, siç tha ai, praktikën e diskriminimit sistematik ndaj shqiptarëve që jetojnë në jug të Serbisë, pasi Gjykata Kushtetuese serbe ia refuzoi ankesën qytetarit nga Medvegja, Safet Demiri, për kthimin e adresës së banimit.

Të enjten presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, kërkoi nga bashkësia ndërkombëtare t'i bëjë trysni Serbisë për respektimin e të drejtave të shqiptarëve në jug të vendit.

Pasivizimi nënkupton fshirjen e qytetarëve prej adresave ku kanë qenë të regjistruar.

Ky hap rezultoi me humbjen e shtetësisë serbe, rrjedhimisht të të gjitha të drejtave civile, përfshirë të drejtën për të votuar, për të pasur pronë, për të pasur sigurim shëndetësor e pension dhe për t'u punësuar.

Pasivizimi i adresës përcaktohet me ligj në Serbi që prej vitit 2011. Ligji parasheh që institucionet të bëjnë kontrolle për të kuptuar nëse një banor jeton në adresën e regjistruar. Nëse vërtetohet që një banor nuk jeton në atë adresë, merret vendimi për pasivizimin e saj, dhe banori obligohet ta regjistrojë adresën e re brenda tetë ditëve pas pranimit të vendimit.

Ndonëse ligji parasheh të drejtën për apel, qytetarët kanë thënë se, në disa raste, as nuk kanë mundur të ankohen ndaj vendimit, pasi nuk janë informuar me kohë për pasivizimin.

Policia gjen armatim dhe uniforma ushtarake në veri

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Policia e Kosovës tha se ka gjetur armatim, uniforma dhe pajisje të tjera ushtarake gjatë një aksioni në një fshat të komunës së Zubin Potokut në veri të Kosovës. Sipas njoftimit, policia ishte duke kërkuar një të dyshuar, të identifikuar me iniciale S. M., që po kërkohet lidhur me një laborator droge të gjetur në fshatin Qukiq disa vjet më parë, e në lokacionin ku dyshohej se gjendej ai, u gjet armatim. "I dyshuari nuk është gjetur në lokacionin ku dyshohej se mund të jetë, mirëpo në pronën e tij, gjegjësisht në mal, në një vend të mbuluar me dhe, janë gjetur uniforma dhe pajisje të tjera ushtarake", u tha në njoftim.

Policia tha se gjatë kontrollit edhe në tri vende të tjera janë gjetur të groposura edhe pajisje të tjera ushtarake. Policia tha se gjeti uniforma

ushtarake, pjesë të pushkëve të gjata, jelekë taktikë, gazmaska, një tytë e pistoletës, një palë pranga dhe 1 471 fishekë të kalibrave të ndryshëm.

Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, tha se armët që po gjenden në veri "nuk janë thjesht mbetje e bandave kriminale e terroriste, por edhe vendstrehim i armëve për planifikimet e tyre të errëta". "Si Qeveri e Republikës së Kosovës, bashkë me Policinë e Kosovës dhe të gjitha institucionet e tjera, jemi të përcaktuar qartë që rendi juridik e kushtetues, sovraniteti e integriteti, rendi dhe ligji, liria, barazia e drejtësia, do të mbizotërojnë gjithandëj shtetit tonë", shkroi ai në "Facebook".

Një ditë më herët Policia e Kosovës njoftoi se gjeti një sasi të konsiderueshme të armatimit gjatë kontrolleve në Zvečan.

Policia tha se ky rast ka të bëjë me një person me interes, që dyshohet të jetë i lidhur me



rastin Banjska. Në shtator të vitit të kaluar në Banjskë të Zveçanit një grup i serbëve të armatosur sulmoi Policinë e Kosovës, duke vrarë reshterin Afrim Bunjaku. Gjatë

shkëmbimit të zjarrit u vranë edhe tre sulmues serbë. Që nga sulmi në Banjskë, policia ka njoftuar disa herë për gjetjen e armatimit dhe uniformave ushtarake në

komunat në veri të Kosovës të banuara me shumicë serbe. Po ashtu, në veri të Kosovës vitet e fundit autoritetet kanë njoftuar për gjetjen dhe shkatërrimin e disa laboratorëve të drogës.

Hashani: 1.3 miliard euro të planifikuara për investime kapitale nuk u shpenzuan



PRISHTINË, 21 NËNTOR - Nga viti 2019 deri në vitin 2023, rreth 1.3 miliard euro të planifikuara për investime kapitale nuk janë shpenzuar, ndërsa investimet e jashtme janë rritur për 7 për qind në gjysmën e parë të vitit 2024. Megjithatë, problematikë mbetet struktura e tyre. Kështu është thënë në raportin e Institutit Riinvest me titull "Si të dilet nga kurthi i rritjes së pamjaftueshme ekonomike dhe si t'i bëjmë investimet më të frytshme?". Sipas raportit, ka një ngecje në krahasim me planifikimet e qeverisë sa i përket normës së rritjes së Produktit Vendor Bruto (PVB).

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Banka Botërore (BB) i shohin lëvizjet ekonomike në Kosovë në një dritë pozitive se vitin e kaluar, veçanërisht në aspektin e stabilitetit makroekonomik dhe performancës buxhetore. Në

fakt, rritja ekonomike është kthyer në trendin para pandemisë Covid-19, rreth 4 për qind.

Drejtori ekzekutiv i Institutit Riinvest, Alban Hashani, ka thënë se raporti jep përgjigje pse rritja ekonomike në Kosovë është në një lloj kurthi. "Vlerësojmë se duhet të bëhet më shumë për ta tejkaluar këtë kurth. Sipas projeksioneve me ekonomi globale, pritjet për vitin vijues nuk është se dallojnë shumë me rritjen ekonomike nga vitet paraprake. Ne jemi kthyer në ritmin e rritjes para pandemisë, por që kjo është e pamjaftueshme. Qeveria e Kosovës, ndër të tjera, duhet të krijojë një trup ekspertësh vendorë dhe ndërkombëtarë për të hartuar një vizion afatgjatë që tejkalon modelin aktual të rritjes dhe kapërcen kurthin e vendeve me të ardhurave mesatare", ka thënë Hashani, duke shtuar se,

sipas perceptimeve të udhëheqësve të kompanive private në Kosovë, viti 2023 ishte më i mirë sesa viti 2024. "Pas një rritje më të ngadalësuar në vitin 2023, ekonomia e Kosovës këtë vit dhe vitin e ardhshëm pritet të rikthehet në ritmet e rritjes para Covid-19 me katër për qind. Sipas perceptimeve të udhëheqësve të kompanive private në Kosovë, viti 2023 ishte më i mirë se viti 2024. 28 për qind e kompanive raportojnë rritje të shitjeve, 55 për qind pa ndryshime dhe 13 për qind rënie. Duhet shtuar dy probleme kronike, përkeqësimi i bilancit tregtar dhe niveli i ulët i pjesëmarrjes në tregun e punës", ka thënë Hashani.

Më tutje, Hashani ka thënë se, bazuar në raport, shqetësuese është mungesa e investimeve kapitale. "Investimet e jashtme direkte (ID) u rritën 7 për qind në gjysmën e parë të vitit 2024, megjithatë problematike mbetet

struktura e tyre. Sektori financiar në Kosovë, i dominuar nga bankat komerciale, vazhdon trendët e stabilitetit dhe qëndrueshmërisë. Kreditë kanë shënuar rritje vjetore prej 15-përqindësh. Rritje më të theksuar kanë pasur kreditë për ekonomitë familjare, krahasuar me firmat, 20 për qind dhe 11 për qind, respektivisht pasqyrojnë edhe strukturën e ekonomisë", ka thënë ai. Sipas tij, shqetësuese është mungesa e investimeve kapitale.

Hashani ka thënë se nga viti 2019 deri në vitin 2023 rreth 1.3 miliard euro të planifikuara për investime kapitale nuk u shpenzuan. "Investimet publike. Rritje nga 789 milionë euro në vitin 2019 në 857 milionë euro në vitin 2023. Gjatë kësaj periudhe, rreth 1.3 miliard euro të planifikuara për investime kapitale nuk u shpenzuan. Në vitin 2023 investimet kapitale",

ka thënë Hashani.

Në fund, Hashani ka thënë se ndërmarrjet publike në pesë vitet e fundit kanë realizuar investime kapitale të konsiderueshme në vlerë mbi 307 milionë euro. "Pavarësisht prej këtyre investimeve, performanca e shumicës së këtyre ndërmarrjeve ka mbetur e njëjtë. Në total prej 59 milionë eurosh të transferuara nga Qeveria e Kosovës, vetëm rreth 9.4 milionë euro janë dhënë për investime kapitale, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga subvencionet", ka thënë Hashani. Ndërsa Sergiy Maslichenko, udhëheqës i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) në Kosovë, ka thënë se ky institucion ndërkombëtar ka investuar rreth 90 milionë euro, shifër kjo më e vogël se në shtetet e rajonit. Shkak për këtë, ai ka thënë se është mungesa e infrastrukturës. (EO)

Opozita kundërshton Projektbuxhetin e 2025-s, e cilëson planifikim kriminal

Kuvendi i Kosovës ka shqyrtuar të enjten në lexim të dytë Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin 2025, i cili kap vlerën e 3.6 miliardë eurove. Projektligji është miratuar në lexim të parë më 11 nëntor. Vlera e projektbuxhetit për vitin 2025 është 9 për qind më e lartë se e buxhetit të vitit 2024, që kishte vlerën 3.3 miliardë euro

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Partitë opozitare sërisht kanë shprehur kundërshtimet e tyre rreth Projektbuxhetit për vitin 2025. Në seancën e Kuvendit të Kosovës, të mbajtur të enjten, ku ky Projektbuxhet kishte ardhur për shqyrtim në lexim të dytë, deputetët opozitarë e kanë kundërshtuar shqyrtimin e tij. Partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, ka thënë se ky buxhet do të sigurojë stabilitet ekonomik dhe mirëqenie për qytetarët.

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka thënë se si grup parlamentar janë të një mendimi që ky Projektbuxhet të mos vihet fare në votim në leximin e dytë. "Kanë dalë një mori planifikimesh kriminale, duke

filluar nga Ministria e Bujqësisë. Votimi i këtij Projektbuxheti do të thotë mbështetje e një planifikimi kriminal mbi ato subvencione e grante që kanë qenë të planifikuara dhe tashmë kanë filluar t'i marrin paratë ata njerëz që janë të përfshirë në këto skema kriminale", ka thënë Tahiri.

Ai ka shtuar se ky buxhet i kontaminuar do të duhej t'i nënshtruhej edhe një diskutimi të thellë. "Në leximin e parë kur ka ndodhur votimi ne nuk i kemi pasur të njohura faktet që kanë dalë pastaj. Kërkoj që ky projektbuxhet të kthehet mbrapa", tha Tahiri.


Deputeti i LDK-së, Armend Zemaj, i cili foli në emër të grupit parlamentar të LDK-së, u shpreh se ky Projektligj ka shkelje kushtetuese. "Mendoj



që kryeministri duhet të paraqitet në këtë seancë dhe ta thotë qartazi nëse është qëllimi për të krijuar krizë financiare me buxhetin vjetor të Kosovës, duke krijuar precedent të shkeljeve kushtetuese brenda këtij ligji, duhet ta thotë qëllimin e tij, qëllim që duhet të kundërshtohet nga të gjithë pa përjashtim. LDK-ja i tregoi elementet bazë ku po shkelen Kushtetuta dhe ligji. Kjo nuk

duhet të lejohet", tha Zemaj. Kurse shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka shtuar se procedura sesi ka ardhur buxheti i vitit 2025 në lexim të dytë në Kuvend, është procedurë e cila do ta turpërojë përgjithmonë jetën parlamentare, një shumicë parlamentare që udhëheq qeverinë. "Në fund të mandatit, pa pasur asnjë nevojë, për asnjë emergjencë, për kurrfarë afati

kohor, seanca kundërligjshëm e fut në debat trajtimin me urgjencë, duke e mbytur dhe ngulfatur mundësinë e deputetëve që të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në hartimin e buxhetit", ka thënë Tahiri, duke shtuar se 9 shkurti do të jetë dita e gjykimit për të gjithë ne. Pas deklarimeve në Kuvend partitë opozitare e kanë lëshuar sallën.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Gazetari rumun: Nuk mund të këndosh 'Serbi, Serbi' para një populli të masakruar nga Serbia

BUKURESHT, 21 NËNTOR - Gazetari dhe komentuesi sportiv rumun Narcis Drejan ia bëri të qartë popullit të vet dhe tifozëve që ditën e ndeshjes Rumani - Kosovë e provokuan keq shtetin e Kosovës dhe popullin në tërësi. Thirrjet "Kosova është Serbi" dhe "Serbi, Serbi" kanë qenë të pranishme gjatë gjithë ndeshjes Rumani - Kosovë zhvilluar mbrëmjen e së premtes në Bukuresht. Jo vetëm kaq, por është vërshëlyer edhe himni dhe janë hedhur sende të forta në fushë. E gjitha kjo në mënyrë të përsëritur e detyroi kapiteni e Kosovës, Amir Rrahmani, që në minutat shtesë të ndeshjes, kur rezultati ishte 0-0, të thotë "mjaft" dhe ta tërheqë ekipin në dhomat e zhveshjes. Drejan thotë se nuk mund të këndosh "Serbi, Serbi" para një populli të masakruar nga Serbia në stilin mesjetar, vetëm 25 vjet më parë. "Një tufë banditësh, shumë me precedentë penalë, mendojnë se është mirë të marrësh një shtet që kaloi tmerret e luftës". Pas kaq ditësh, UEFA vendosi në favor të Rumanisë për ndeshjen e ndërprerë ndaj Kosovës të premtën e kaluar, duke i gëzuar rumunët me një fitore me rezultat zyrtar, 3:0. E ky vendim u kundërshtua fuqishëm nga Federata e Futbollit e Kosovës, e cila paralajmëroi se do të ankohe në Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv - CAS në Lozanë. Por, Kosova nuk është e vetmja palë e pakënaqur dhe që konsideron se u dëmtua nga Komisioni Disiplinor i shtëpisë së futbollit evropian. Nga ky vendim është prekur edhe Suedia pasi me fitoren ndaj Kosovës, Rumania u bë ekipi më i mirë i Ligës C në Ligën e Kombeve në përgjithësi dhe iu rritën gjasat për t'u kualifikuar në Kupën e Botës. Me një barazim mes Rumanisë dhe Kosovës, Suedia në fakt do



të ishte ekipi më i mirë i Ligës C, por me këtë vendim e bëri një hap prapa pasi suedezët e mbyllën grupin me 16 pikë, kurse rumunët me 18. E suedezët, të cilët u prekën nga ky vendim, kanë paralajmëruar po ashtu se do të ankohe në CAS ndaj vendimit të UEFA-s, të cilin e konsiderojnë si të padrejtë dhe duke e favorizuar një palë.

Pse është aq e rëndësishme të jesh ekipi më i mirë i Ligës që i takon?

Katër fituesit e Ligave, A, B, C e D, të cilët nuk përfundojnë në dy vendet e para në kualifikimet e rregullta të Botërorit, do ta kenë mundësinë që të luajnë në "play-off" për t'u kualifikuar në Kupën e Botës, duke iu bashkuar në këtë fazë 12 ekipeve kombëtare që do të përfundojnë në vendet e dyta në grupe të eliminatorëve. Për këtë arsye, suedezët nuk e përjashtojnë mundësinë e ankesës. "Ne po shpresonim që vendimi i UEFA-s të vinte para

lojës sonë", ka deklaruar menaxheri i Kombëtars, Stefan Pettersson pas fitores së Suedisë të martën mbrëma. E menaxheri i futbollit në Federatën Suedeze të Futbollit, Kim Kallstrom thotë se kjo Federatë po i shqyrton krejt opsionet e saj, duke mos e përjashtuar mundësinë e ankesës. "Pas fitores sonë ne e kemi pritur njoftimin e UEFA-s për rezultatin e ndeshjes mes Rumanisë dhe Kosovës. Tash erdhi vendimi, i cili nga ana e jonë është negativ. Vendimi ka të bëjë kryesisht me skuadrat e përfshira, por jemi duke e shqyrtuar mundësinë e ankesës. Është e trishtueshme që sjellja jashtë fushës ka një ndikim në rezultatin sportiv dhe kjo ndikon si në skuadrat e përfshira, ashtu edhe tek ne", u shpreh Kallstrom. Kombëtarja e Kosovës u tërhoq nga fusha në fundin e ndeshjes me Rumaninë në Bukuresht teksa rezultati ishte i barabartë, 0:0. Thirrjet raciste ndaj ekipit dardan bënë që lojtarët të vendosin të mos kthehen më në fushë dhe gjyqtari e mbylli kështu lojën pas një pritjeje prej rreth 50 minutash.

SHKURT

Peja ndahet me basketbollistin Cowart

Skuadra e Pejës në basketboll ka njoftuar se është ndarë me basketbollistin Darnell Cowart Jr. Ky i fundit ishte pjesë e KB Peja nga shtatori i vitit të kaluar. "KB Peja njofton që basketbollisti Darnell Cowart Jr. nuk do të jetë më pjesë e skuadrës sonë për pjesën e mbetur të sezonit. Cowart ishte pjesë e skuadrës nga muaji shtator, por pas disa mosmarrëveshjeve kemi vendosur të mos vazhdojmë aventurën e përbashkët", thuhet në njoftimin e Pejës.

Suedia ankohet në CAS për fitoren e Rumanisë në tavolinë ndaj Kosovës

UEFA vendosi që Rumania të fitojë 3-0 në tavolinë ndeshjen ndaj Kosovës. Ky rezultat bëri që rumunët ta kenë skuadrën më të mirë në Ligën C të Ligës së Kombeve, duke pasur kështu shanse reale për "play-off"-in e Botërorit. E dëmtuar në këtë rast është Suedia, kombëtare e cila ka dalë në vendin e parë në grupin përkatës të Ligës C, por nuk mund të jetë më e mira, pas suksesit 3-0 të Rumanisë. Në këto kushte, suedezët do ta kundërshtojnë në CAS vendimin e UEFA-s. "Pas fitores së pastër ndaj Azerbajxhanit kemi pritur njoftimin e UEFA-s lidhur me rezultatin e ndeshjes Rumani - Kosovë. Tani është marrë një vendim i cili për ne është negativ. Vendimi prek kryesisht skuadrat e përfshira, por ne po shqyrtojmë opsionet për ta kundërshtuar. Është për të ardhur keq që gjërat që ndodhën jashtë fushës kanë ndikim në rezultatin sportiv dhe prekin të dyja skuadrat e përfshira, por edhe neve", ka thënë Kim Kallstrom, menaxher i Federatës Suedeze të Futbollit.

Pas Juventusit e Interit, edhe Napoli në garë për Ismajlin

Ardian Ismajli po zhvillon një super sezon duke tërhequr gjithnjë e më shumë vëmendjen e klubeve të mëdha në Itali. Kapiteni kuqezi nuk e fshehu këtë fakt, ku gjatë grumbullimit me ekipin përfaqësues pranoi se ka interesim nga disa klube, por lista sa vjen e shtohet. Pas Juves dhe Interit, që prej kohësh po kërkojnë informacion për Ismajlin, kësaj liste së fundmi i është shtuar edhe Napoli. Sipas "La Repubblica"-s, drejtori sportiv i Napolit është vënë në lëvizje për t'i gjetur Contes një mbrojtës të ri, për më tepër tani që edhe Juan Jesus është gjithnjë e më larg Napolit. Ismajli vlerësohet shumë nga drejtuesit e bluve, e vërtetoi edhe ndaj tyre se është një lojtar me shumë potencial teksa neutralizoi një gjigand si Lukaku. Gjithnjë sipas "La Repubblica"-s, Napoli do të tentojë që në janar ta bindë qendërmbrojtësin kuqezi. Nuk është aspak çudi nëse në Napoli do të shohim një dyshe shqiptarësh në zemër të mbrojtjes, Rrahmani - Ismajli.

Rahoveci pret përkrahjen e shikuesve në ndeshjen me skuadrën rumune

Rahovec, 21 nëntor - Të shtunën prej orës 19:00 në palestrën "Mizahir Isma" në Rahovec zhvillohet ndeshja e parë e raundit të tretë të Kupës Evropiane (EHF European Cup). Kampioni i Kosovës, Rahoveci, përballlet me skuadrën e njohur rumune Minaur Baia Mare.

Nëse e kalon këtë raund garash, Rahoveci do të arrijë sukses historik për hendbollin e Kosovës. Por Minaur Baia Mare është prej skuadrave më të forta në Kupën Evropiane dhe "vreshtarët" i presin dy ndeshje shumë sfiduese. Baia Mare ka suksese të shumta si

në Rumani ashtu edhe në garat kontinentale. Ka përbërje cilësore me plot hendbollistë cilësorë të huaj dhe llogaritet favorite ndaj kampionit të Kosovës. Por të Rahoveci janë të përkushtuar për të dhënë më të mirën në kërkim të suksesit. Për këtë e presin edhe përkrahjen e

shikuesve në tribuna. Në ndeshjen e kaluar evropiane të Rahovecit, palestra "Mizahir Isma" ishte e mbushur me shikues. Dhe rahovecasit shënuan fitore bindëse ndaj Bocholtit belg për të avancuar në raundin e tretë. Ndeshja e kthimit është në Rumani, kurse fillimisht i



gjithë fokusi është te ndeshja e së shtunës mbrëma në Rahovec.

Bucsi i pandalshëm me Antetokoumpon, fiton edhe Warriorsi

Ohio, 21 nëntor - Cleveland Cavaliersi rikthehet te fitorja në NBA duke mundur me rezultat 128-100 New Orleansin dhe mbrojtur kreun e renditjes në Lindje. Shtatë lojtarë të Cavaliersit realizuan mbi 10 pikë, ku u dallua Ty Jerome me 29 pikë, që i bëri të

pavlefshme 34 pikët e Reevesit për miqtë. Pa probleme fitoi edhe skuadra e Milwaukee, që mundi me rezultat 122-106 Chicagon, ndeshje ku Antetokoumpon realizoi 41 pikë. Houstonin, falë 31 pikëve e 12 reboundeve të Sengunit, mundi me rezultat 130-113

Indianan, duke ngjitur shkallët në renditje. Në krye të renditjes në Konferencën e Perëndimit ngjitet ekipi i Golden States, që mundi me rezultat 120-97 Atlantan. Wiggins me 27 pikë e Curry me 23 pikë bënë dallimin mbi parket për skuadrën e

Warriorsit. Triumfoi edhe skuadra e Clippersave, që mundi me rezultat 104-93 Orlandon, ndeshje ku shkëlqeu Hardeni, autor i 24 pikëve. Nuk zhgënjeu skuadra New York, që falë 34 pikëve të Townsit mundi me rezultat 133-122 Phoenixin.



Rezultatet: Cleveland-New Orleans (128-100), Milwaukee-

Ronaldo: Thonë se jam i mbaruar, por ende luaj me pasion

RIYADH, 21 NËNTOR - Platforma "Netflix" ka publikuar një dokumentar të ri mbi Ligën e Arabisë Saudite, të titulluar "Saudi Pro League: një epokë e re". Një nga protagonistët kryesorë të këtij dokumentari është Cristiano Ronaldo, i cili në janar të vitit 2023 iu bashkua klubit Al Nassr, duke nisur një kapitull të ri në karrierën si futbollist profesionist, ndoshta i fundit në nivel klubesh.

Rrugëtimi i Ronaldos drejt Arabisë Saudite

Cristiano Ronaldo mbërriti në Arabinë Saudite pas përfundimit të periudhës së tij të dytë te Manchester Unitedi. Futbollisti portugez vendosi të largohej nga klubi anglez për shkak të rolit të kufizuar që kishte në skemën e trajnerit Erik ten Hag dhe marrëdhënies së tensionuar me teknikun holandez. Pas përfundimit të Kupës së Botës "Katar 2022", Ronaldo firmosi për Al Nassrin, ku vazhdon të luajë edhe sot. Dokumentari eksploron ndikimin e tij dhe të lojtarëve të tjerë të famshëm në transformimin dhe rritjen e Ligës Saudite si një destinacion i ri për futbollistët e nivelit të lartë.

CR7: Jam këtu për të fituar dhe për të lënë një trashëgimi

Në dokumentarin e "Netflix", Cristiano Ronaldo, thekson se ende ndien të njëjtin pasion për futbollin si gjithmonë dhe se qëllimi i tij me transferimin tek Al Nassri ishte të linte një trashëgimi: "Erdha për të fituar, për ta përmirësuar ligën. Dua të lë një trashëgimi. Kjo është ajo



që dua. Thonë se jam i mbaruar, se jam këtu vetëm për para..., por ende luaj me pasion. Nuk e besojnë, por unë jam këtu për të fituar".

Ndikimi i Ronaldos në Ligën Pro Saudite

Ronaldo ka hapur dyert për lojtarë të mëdhenj që të transferohen në Arabinë Saudite, duke e rritur ndjeshëm nivelin e ligës së saj të futbollit. Klube si Al Hilal, Al Ittihad dhe Al Ahli, kanë tërhequr emra të njohur botërorë. Al Hilal, klubi për t'u mposhtur, numëron lojtarë si Bono, Joao Cancelo, Renan Lodi, Koulibaly, Milinkovic-Savic, Ruben Neves, Mitrovic dhe Neymar (ky i fundit ka qenë i kufizuar për shkak të një dëmtimi serioz në gju). Al Ittihad ka në radhët e tij lojtarë si Kanté, Fabinho, Aouar, Moussa Diaby dhe Karim Benzema. Sulmuesi francez iu bashkua klubit saudit një vit pas fitimit të "Topit të Artë". Al Ahli ka transferuar lojtarë të rëndësishëm si Edouard Mendy, Kessié, Gabri Veiga, Mahrez, Firmino dhe Ivan Toney.

Statistikat mbresëlënëse të Ronaldos

Që nga mbërritja tek Al Nassri, Ronaldo ka luajtur 79 ndeshje, duke shënuar 68 gola dhe dhënë 18 asiste. Në sezonin 2023-2024 ai ishte golashënuesi më i mirë i vitit (përfshirë dhe golat me kombëtarën), me 57 gola. Aktualisht, tek Al Nassri e ndan dhomën e zhvishjes me yje si Laporte, Brozovic, Otavio dhe Sadio Mane, duke synuar t'i japë fund dominimit të Al Hilalit.

Synimi i 1 000 golave dhe e ardhmja

Me 910 gola të shënuara deri tani, Ronaldo ka një synim ambicioz: ta arrijë shifrën e 1 000 golave. Por, siç e pranoi vetë pas fitores së Portugalisë kundër Polonisë (5-1), ka të ngjarë të tërhiqet nga futbollit brenda një ose dy vitesh: "Nëse duhet të ndodhë, parashikoj brenda një ose dy vitesh. Nuk e di, së shpejti mbush 40 vjeç". Edhe pse ky rekord duket i paarrtshëm, Ronaldo vazhdon ta shkruajë historinë, me ndikim të pashlyshëm në futbollin botëror.

SHKURT

U hodh shorti për rrethin e parë të Kupës së Kosovës për Femra

Të enjten në selinë e Federatës së Futbollit të Kosovës është hedhur shorti për rrethin e parë të Kupës së Kosovës në konkurrencën e femrave. Në këtë rreth do të zhvillohen katër ndeshje, të cilat pritet të jenë rivalizuese. Në shortin e hedhur, krahas përfaqësuesve të klubeve, ishin të pranishëm edhe Valbona Gashi-Uka, shefe e futbollit të femrave, Agron Shosholli, anëtar i Komisionit të Garave dhe Bujar Abdullahu, administrator i ligave të femrave. Ekipet kryesuese të Superligës së Kosovës, përkatësisht Mitrovica, Dukagjini, Malisheva dhe Ulpiana, do t'u bashkohen garave në rrethin e dytë. Ndeshjet e këtij rrethi do të zhvillohen në mars 2025: Llapi-Vizioni, Presingu-Intelektualet, Prishtina-Feronikeli, Kosova VR-Jakova.

Galatasaray synon transferimin e yllit të Tottenhamit

Galatasaray është gati të bëjë një transferim sensacional. Pas lamtumirës së lojtarëve si Tete, Wilfried Zaha dhe Kerem Akturkoglu, gjatë afatit kalimtar të fundit, klubi turk planifikon një lëvizje ambicioze, të sjellë në Stamboll yllin koreano-jugor të Tottenhamit, Heung-min Son. Me skadimin e kontratës së 32-vjeçarit në qershorin e ardhshëm, Galatasaray synon t'i nisë negociatat që në janar, duke tentuar ta "rrembejë" nga Tottenhami me një çmim të pranueshëm. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, Galatasaray do të provonte sërish të bënte diçka të tillë në merkaton pasuese.

Rodri shpjegon pse Messi është superior ndaj Ronaldos

Rodri ka ndarë mendimet e tij për debatin e vazhdueshëm mes dy prej më të mëdhenjve të historisë, Cristiano Ronaldos dhe Lionel Messit. Në një intervistë të fundit, fituesi aktual i "Topit të Artë" shpjegoi pse beson se Messi dallohet si lojtari superior. Rodri deklaroi se ndërsa Ronaldo përputhet me arritjet e Messit, ai nuk posedonte të njëjtin talent natyral. "Cristiano arriti të përballlet me Messin pa një talent të lindur. Por, ne që luajmë kundër tyre, e kuptojmë ndryshimin", ka thënë fillimisht Rodri. Spanjollit gjithashtu përshkroi aftësinë e Messit për të ndikuar në lojë. "Messi merr topin dhe ju thoni: 'Rrezik'. Kur ju filloni të luani kundër tij, të përpiqeni t'ia hiqni topin, ai ju shmang sikur të ishit asgjë". Rodri përfundoi duke reflektuar mbi ndjenjat e lojtarëve që përballëshin me Messin në fushë, duke thënë: "Kur ai mori topin, kishte ndjenjën se diçka e keqe do të ndodhte". Ai, gjithashtu, ia dedikoi "Topin e Artë" brezit të kaluar të të mëdhenjve të Spanjës, duke e quajtur atë "të padrejtë" që ata kurrë nuk e fituan çmimin prestigjioz.

Nadali: Doja të vazhdoja, por trupi im nuk më lejon të luaj më

Dita e mërkurë ishte shumë emocionuese për Rafael Nadal, që mbylli zyrtarisht karrierën. Ai u përlot disa herë, fillimisht gjatë himnit të kombëtares spanjolle, përpara se të dilte në fushë dhe më pas gjatë fjalimit lamtumirës. Fjalët e

emocionuan vetë Nadalin si dhe të gjithë ata që e dëgjuan. "Jam i privilegjuar që kam marrë dashurinë e gjithë botës, veçanërisht të spanjollëve. Nuk shkoi siç shpresoja, por dhashë gjithçka që kisha", ka thënë Nadali. "Kjo është dita ime e

fundit si një tenist profesionist. Nuk është kurrë e lehtë të ndalosh, unë ende e dua tenis deri në vdekje, por nuk mund të jem më konkurrues", ka shtuar kampioni nga Majorka. "Trupi im nuk më lejon të luaj më. Unë përqafoj familjen time

dhe të gjithë miqtë e mi. Gjatë njëzet vjetëve të mia si profesionist jam përpjekur të ndërroj sa më pak staf dhe gjithmonë kam pasur pranë vetes njerëzit që kam dashur", ka shtuar spanjollit. "Nuk e mendoja se mund të kisha një karrierë kaq të suksesshme.

Familja ime më mësoi edukimin dhe më ndihmoi të mbaja gjithmonë këmbët në tokë. Sigurisht që do të më kujtojnë për turnetë që kam fituar, por më intereson më shumë që të kujtohem si një person i mirë", ka përfunduar Nadali.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Condor" Sh.p.k Kramovik, Rahovec në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e prodhimit të betonit në Miradi e Epërme, Fushë Kosovë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 16.01.2025 në ora 10:00 në Shkollën Fillore e Mesme e Ulët "Vëllezrit Frashëri", në Fushë Kosovë do të organizohet debat publik nga Kompania "Condor" Sh.p.k Kramovik, Rahovec në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPr68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943
Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Condor" Sh.p.k Kramovik, Rahovec për bazën e prodhimit të betonit në Miradi e Epërme, Fushë Kosovë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom/Agency for Administration of Sequestered and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik Rishpallje

Datë 21.11.2024

Referenca: AAPSK – 013/2024

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	Kamion Mercedes 814, viti i prodhimit 1990; dizel, ngjyrë e kaltër -me targa vendore	1 copë	3,150.00 €		
2	VW Caddy 2.0,viti i prodhimit 2008, dizel, ngjyrë e bardhë- -me targa të huaja	1 copë	2,430.00€		
3	VW Passat, dizel, ngjyrë e kaltër -për skrap	1 copë/ për skrap	244.08€		
4	VW Golf III viti i prodhimit 1994, dizel ngjyre vishnje -me targa vendore	1 copë	1,200.00€		
5	Suzuki FJ JIMNY viti i prodhimit 2001, benzin, shume ngjyrësh -me targa vendore	1 copë	4,200.00€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri më **27.11.2024 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahitri (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë.**

Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: **27.11.2024**, prej orës 10:00-11:00 në **Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë.**

Pasurit e sekuestruar ose te konfiskuara ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr. 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se në: <https://aapks.rks-gov.net> apo <https://md.rks-gov.net/> Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Sektori i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00.Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 67 254

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "4YouFacial" Sh.P.K. me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811954024 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "4YouFacial" D.O.O. od Gjilan, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811954024 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "4YouFacial" L.L.C. with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 811954024 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Mondiall-Ks" Sh.p.k Gllamnik, Podujevë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun solar me kapacitet 2 MW në Gllamnik komuna e Podujevës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 17.01.2025 në ora 10:00 në Shkollën Fillore e Mesme e Ulët "Kongresi i Manastirit", në fshatin Gllamnik të Podujevës do të organizohet debat publik nga Kompania "Mondiall-Ks" Sh.p.k Gllamnik, Podujevë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPr68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943
Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Mondiall-Ks" Sh.p.k Gllamnik, Podujevë për parkun solar me kapacitet 2 MW në Gllamnik komuna e Podujevës.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT




SWISS

TAVERNA




Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



Lumë's Details

Estetik & Depilim



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë-Ministraskoo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom/Agency for Administration of Sequestrated and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik Rishpallje

Datë 21.11.2024

Referenca: AAPSK – 013/2024

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	Kamion Mercedes 814, viti i prodhimit 1990; dizel, ngjyrë e kaltër -me targa vendore	1 copë	3,150.00 €		
2	VW Caddy 2.0,viti i prodhimit 2008, dizel, ngjyrë e bardhë- -me targa të huaja	1 copë	2,430.00€		
3	VW Passat, dizel, ngjyrë e kaltër -për skrap	1 copë/ për skrap	244.08€		
4	VW Golf III viti i prodhimit 1994, dizel ngjyre vishnje -me targa vendore	1 copë	1,200.00€		
5	Suzuki FJ JIMNY viti i prodhimit 2001, benzin, shume ngjyrësh -me targa vendore	1 copë	4,200.00€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri më 27.11.2024 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahtiri (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë.

Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 27.11.2024, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë.

Pasurit e sekuestruar ose te konfiskuara ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr. 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se në: <https://aaprk.gov.net> apo <https://md.rks.gov.net/> Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Sektori i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00.Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 67 254

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Gazmend Cana B.I shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër UNIK: 810495590.

- Besart Ymeri shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit "AAB-RIINVES" me numër diplome" 671/09.

- Raif Shushnajku B.I emri tregtar N.T.P "ERISI COMM", shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër UNIK: 810902264.

- Petrit Halili, shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SHMLE "Hasan Prishtina".

- Kushtrim Halili, shpall të pavlefshme dëftesat e sh.m.l.e. "Hasan Prishtina".

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

